



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 27.1.2025

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen me objekt: Ankim kundër vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dosti
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe propësimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 4.2.2022 dhe parashtrimeve të datës 13.12.2024, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

I. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. *Mbi ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të në Deklaratën Vetting.*

1.1 Fillimisht çmojmë të sjellim në vëmendje se pasuritë e deklaruara në Deklaratën “Vetting”, referuar rrethanave konkrete të faktit, i nënshtrohen kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim apo ndonjë lloj kriteri përcaktues, sipas standardeve të vendosura nga legjislacioni i posaçëm dhe jurisprudenca tashmë e konsoliduar e Kolegjit.

1.2 Sikurse është trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 4.2.2022, nga aktet e administruara në dosje të Komisionit rezulton se, në total, pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, në momentin e dorëzimit të Deklaratës “Vetting”, janë në vlerën 4.950.000 lekë dhe 195.000 euro¹ (pa përfshirë këtu vlerën e apartamentit në Kuçovë, të përfutur nga privatizimi).

1.3 Nga shqyrtimi në tërësi i akteve të administruara në dosje, konstatojmë se si burim krijimi për këto pasuri, ndër të tjera, janë deklaruar: (i) Të ardhurat nga emigracioni në shtetin grek, për periudhën nga viti 1992 deri në vitin 2000, në shumën 14.000.000 lekë; (ii) Të ardhurat nga punësimi në shoqërinë “***. ***. ***”, në formën e partneritetit, për periudhën shtator 2000 deri në vitin 2010, në shumën nga 8.000.000 lekë deri 10.000.000 lekë; (iii) Të ardhurat nga shitja e lokalit në qytetin e Kuçovës, në vitin 2005, në shumën 12.800.000 lekë; (iv) Të ardhurat nga puna si avokat për periudhën 2008 – 2011, mbi 5.000.000 lekë. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit, për pjesën më të madhe të të ardhurave të tjera të realizuara ndër vite, deklaroi se kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

1.4 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vëren se subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, lidhur me burimet e krijimit të pasurive të deklaruara prej tij dhe personave të lidhur me të, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nuk ka paraqitur akte të reja për të provuar të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

1.5 Lidhur me të ardhurat e deklaruara me burim nga emigracioni, vlerësojmë se, edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor në Kolegj, mbeti e paprovuar ligjshmëria e të ardhurave të deklaruara me burim nga emigracioni, në kuptim të nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës. Këto të ardhura të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit mbetën në nivel deklarativ, parë në raport me kohën, mënyrën dhe territorin ku janë krijuar, duke mos gjetur mbështetje në dokumentacion ligjor, i cili duhet të provojë: (i) ekzistencën e një burimi real të ardhurash të ligjshme dhe (ii) vlerën reale të të ardhurave të krijuara nga personi deklarues dhe jo të mundësisë objektive për t'i realizuar këto të ardhura me punë, duke i ekuivalentuar me mundësinë potenciale për të krijuar të ardhura gjatë periudhës së pretenduar.

1.5.1 Sikurse është trajtuar në ankimin e datës 4.2.2022 dhe parashtimet e datës 13.12.2024, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit², vlerësojmë se jo gjithmonë *remitancat* mund të konsistojnë në dërgesa të vlerave monetare të krijuara nga burime të ligjshme dhe të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në kuptim të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

¹ Në D-Vetting subjekti dhe personat e lidhur kanë deklaruar pasuritë si vijon: (i) Apartament banimi me sip. (rreth 80 m²), në bashkëpronësi, privatizuar nga shteti në vitin 1992, me vendndodhje në Kuçovë; (ii) Autoveturë, marka “Mercedes Benz”, blerë në vitin 2003, me të ardhura nga puna. Vlera 800,000 lekë, (në kontratë konstatohet se vlera është 950.000 lekë); (iii) Hua dhënë shtetasve ***. ***. dhe ***. ***, në shumën 100.000 euro; (iv) Depozitë në bankën ***, në vlerën 50.000 euro; (v) Depozitë në bankën *** ***, Albania, në vlerën 45.000 euro; (vi) Depozitë në bankën *** ***, Albania, në vlerën 4.000.000 lekë.

² Ky interpretim i Kolegjit gjen shprehje posaçërisht në vendimet e juridiksionit të rivlerësimit nr.14/2021, nr. 21/2021 dhe nr. 23/2020.

1.5.2 Duke përfunduar, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruar nga emigracioni dhe, si të tilla, ato nuk duhen konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës, dispozitë e cila kërkon që për përcaktimin e ligjshmërisë së të ardhurave duhet që të ardhurat të jenë krijuar nga burime të ligjshme, të jenë deklaruar dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse.

1.6 *Lidhur me të ardhurat e deklaruar me burim nga bashkëpunimi me shoqërinë “***. ***. ***” sh.p.k.* vlerësojmë se, edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 4.2.2022 dhe parashtrimet e datës 13.12.2024. Të ardhurat e deklaruar nga subjekti, të pretenduara me burim punësimin/marrëdhënien me shoqërinë “***. ***. ***” sh.p.k., nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës dhe mbeten në nivel deklarativ, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor, burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, as në formën e një marrëdhënieje punësimi me këtë shoqëri dhe as në formën e një marrëdhënieje kontraktuale të një lloji tjetër³.

1.6.1 Sa më sipër çojmë se vlera e të ardhurave të deklaruar si të realizuara nga bashkëpunimi me shoqërinë “***. ***. ***” sh.p.k., nuk provohet se është një e ardhur e realizuar nga një burim i ligjshëm dhe për të cilën janë paguar detyrimet përkatëse tatimore, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit.

1.7 *Lidhur me të ardhurat e deklaruar me burim nga shitja e lokalit në qytetin e Kuçovës*, vlerësojmë se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, mbeti e pa provuar ligjshmëria e të ardhurave të pretenduara me burim nga shitja e lokalit në qytetin e Kuçovës, në vlerën 12.800.000 lekë, pasi këto të ardhura nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për përfitimin e shumës 12.800.000 lekë, në mungesë të provave dokumentare, mbeten të një natyre deklarative dhe vijnë në kontradiktë me përmbajtjen e një akti me vlerë të plotë ligjore, siç është kontrata e shitblerjes së pasurisë të paluajtshme nr. ** rep., nr. ** kol., datë *.1.2005, në të cilën çmimi i shitjes është përcaktuar në vlerën 3.900.000 lekë.

1.7.1 Ashtu sikurse dhe Kolegji është shprehur në vendimin (JR) nr. 52/2023, datë 13.12.2023, përmbajtja e kontratës noteriale konsiderohet si referim ligjor për sa parashikohet në të, për sa kohë që nuk ekzistojnë prova shkresore me vlerë provuese të plotë apo të dhëna të rëndësishme që burojnë nga burime të pavarura dhe jashtë këtij procesi, që të sugjerojnë për të kundërtën.

1.8 Në rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, në vlerësim të të gjitha të dhënave të mbledhura gjatë hetimit administrativ, është konstatuar se të ardhurat të cilat

³ Referohuni jurisprudencës së Kolegjit, ku gjen interpretim rëndësia e veçantë që merr provueshmëria me dokumentacion e pretendimeve të ngritura nga subjektet në procesin e vlerësimit të kriterit pasuror. Ky interpretim i Kolegjit gjen pasqyrim, ndër të tjera, në vendimet e juridiksionit të rivlerësimit nr. 5/2020, nr.14/2019, nr. 7/2019 dhe nr. 9/2018.

subjekti i rivlerësimit ka arritur t'i provonte me dokumentacion ligjor, kanë vlerën 10.246.150 lekë, ndërkohë që pasuria e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, me burim këto të ardhura, rezultojnë të jetë në vlerën 195.000 euro dhe 4.950.000 lekë (në total rreth 31.000.000 lekë).

1.9 Duke përfunduar për vlerësimin e kriterit të pasurisë, çmohet se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 4.2.2022 dhe se mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e deklaruar, e klasifikon subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë.

II. Lidhur me vlerësimin e kriterit të figurës

2. Lidhur me shkakun ankimor mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti, sikundër trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 4.2.2022, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), në vijim të informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit me anë të raportit nr.*** prot., datë **.2.2021, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe i ka referuar Komisionit: *“Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arben *** Dosti”*.

2.1 Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, trupi gjykues, lidhur me këtë raport, vendosi të shkojë pranë agjencive ligjzbatuese për t'u njohur me të njëjtin informacion, me të cilin është njohur edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në kuadër të procesit të rivlerësimit, për subjektin e rivlerësimit Arben Dosti, dhe kreu vetë veprime vijuese hetimore, duke u njohur në burim me informacionin e agjencive ligjzbatuese.

2.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vëren se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, situata faktike lidhur me mungesën e përgjigjes nga ana e autoriteteve përkatëse të Republikës së Greqisë, për të verifikuar në rast se në ngarkim të subjektit të rivlerësimit është dhënë ndonjë vendim gjyqësor penal gjatë qëndrimit në territorin grek, mbeti e pandryshuar.

2.2.1 Sa më sipër, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se, në këto kushte, Raporti i DSIK-së, *“Mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Arben *** Dosti”*, nr.*** prot., datë **.2.2021, mbetet akti i referuar, për sa përmban si konstatim.

III. Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

3. Denoncim i shtetasës * (***)**

3.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se, edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit konkret mbeten të njëjta.

3.2 Në vlerësimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me zbatimin e nenit 55 dhe 64 të Kodit Penal, për verifikimin ose jo si përsëritës në kryerjen e veprave penale, të kryera me dashje, të personit në gjykim,

nuk gjen mbështetje në situatën faktike dhe juridike të rastit konkret, duke evidentuar minimalisht dobësi/mangësi në aftësitë profesionale të subjektit.

3.3 Bashkimi i dënimeve në një të vetëm nuk mund të interpretohet si rrethanë, e cila karakterizon personin i cili ka kryer disa vepra penale, si person jopërsëritës dhe të legjitimojë dhënien e masës lirim me kusht. Vetë neni 55 i Kodit Penal, ndër të tjera, shprehet se: [...] *Kur veprimet apo mosveprimet përmbajnë elementet e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendim, gjykata cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar [...].*

3.4 Lirimi me kusht, i parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, nuk është një dispozitë detyruese, pasi ajo parashikon se i dënuari me burgim mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit, vetëm për arsye të veçanta. Duke parashikuar mundësinë e liritimit me kusht, ligjvënësi ka parasysh veprën penale që ka kryer i dënuari, rrezikshmërinë shoqërore që ajo paraqet, kohën e vuajtjes së dënimit e për më tepër sjelljet e veprimet për riparimin e raporteve të cenuara si ndaj interesave shtetërore ashtu dhe marrëdhëniet me personat e dëmtuar nga vepra penale.

3.5 Dispozita ligjore nuk identifikon apo kategorizon në mënyrë shteruese “rrethanat” që lejojnë lirimin e të dënuarit nga vuajtja e dënimit për pjesën e mbetur të tij, duke i lënë hapësirë Gjykatës për të vlerësuar në çdo rast konkret arsyet e parashtruara nga i dënuari. Është e rëndësishme të përgjithësohet qëndrimi se “arsyet e veçanta” që justifikojnë lirimin e parakohshëm të të dënuarit duhet të kenë natyrë jetike dhe të burojnë nga shkaqe shëndetësore, familjare ose shoqërore që diktojnë në mënyrë të detyrueshme vijimësinë e edukimit dhe rehabilitimit të të dënuarit pranë familjes, komunitetit apo nën kujdesin e nevojshëm mjekësor. Praktika gjyqësore ka zgjeruar kufijtë e vlerësimit dhe në drejtim të llojit të veprës penale, rrezikshmërisë së autorit dhe kohës së shkurtër të pavuajtur nga dënimi penal (vendimi nr. 445, dt. 8.10.2008, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

3.6 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 2, datë 25.5.2015, kanë ardhur në përfundimin unifikues se: *“Ligjvënësi duke përdorur shprehjen “arsye të veçanta” ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të Gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë, këto “arsye të veçanta” nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të liritimit para kohe me kusht, i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër, veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky interpretim i paragrafit të parë të nenit 64 të Kodit Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe “arsyet e veçanta” nuk janë gjë tjetër veçse fakte, të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri”.*

3.7 Po ashtu, mbeti e provuar se subjekti nuk ka marrë në konsideratë as elementet e trajtuara nga Gjykata e Lartë në vendimin unifikues nr. 2, datë 25.5.2015, të cilin vetë

subjekti i rivlerësimit e ka sjellë në vëmendje. Ndër të tjera, në këtë vendim unifikues është interpretuar se: [...] *(i) Natyra e veprës penale të kryer është një nga elementet më të rëndësishme që duhet të merret parasysh nga ana e Gjykatës në shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht. Sa më e lartë të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer, aq më i thellë duhet të jetë hetimi gjyqësor në lidhje me riedukimin e të dënuarit. (ii) Qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës është elementi i dytë që ligji parashikon për t'u trajtuar në raportin e Drejtorit të IEVP-së. Pendimi i të dënuarit duhet të rezultojë nga të dhëna objektive [...].*

3.8 Në ndryshim nga sa parashtron subjekti i rivlerësimit, rezulton se ndaj shtetasit *** ***, në momentin e gjykimit të kërkesës për lirim me kusht, rëndonin dy vendime gjykate të formës së prerë, sipas të cilave ai ishte dënuar me burgim për kryerjen me dashje të dy veprave penale. Nga përmbajtja e dy vendimeve të Gjykatës rezulton se faktet penale për të cilët *** *** është gjetur fajtor, janë kryer në periudha të ndryshme kohore dhe më konkretisht: a) Me vendimin nr. ***, datë **.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, shtetasi *** *** është deklaruar fajtor për veprën penale të “*Dhuna në familje*”, parashikuar nga neni 130/a, paragrafi 4 i Kodit Penal, në lidhje me faktin penal të kallëzuar në datën **.10.2013, nga ana e bashkëshortes së tij *** ***; b) Me vendimin nr. ***, datë **.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, shtetasi *** *** është deklaruar fajtor për veprën penale të “*Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve*”, parashikuar nga neni 278/2 dhe 278/3 të Kodit Penal, në lidhje me faktin penal të konstatuar në datën **.3.2014, ku gjatë kontrollit të banesës së këtij shtetasi është gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri automatike dhe municione.

3.9 Nga sa më sipër rezulton se shtetasi *** ***, fillimisht, ka kryer një veprë penale me dashje direkte, siç është ajo e parashikuar nga neni 130/a, paragrafi 4, i Kodit Penal dhe, pas disa muajsh, ai ka kryer përsëri një veprë penale me dashje, siç është ajo e parashikuar nga neni 278/2 e 278/3 i Kodit Penal, duke qenë në këtë mënyrë para një përsëritësi në krim, kriter ndalues në aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal.

3.10 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se mangësitë e rezultuara në rastin konkret, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit duhen vlerësuar sipas indikatorëve të përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, dhe të mbahen në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose në vlerësim tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

4. Denoncim i shoqërisë “*” sh. a.**

4.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme konstaton se subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën e datës **.12.2024, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *unë në një çështje të mëparshme në kohë, kam paraqitur kërkesë për heqje dorë tek Kryetari i Gjykatës, i cili me të njëjtin arsyetim si më sipër, nuk ka pranuar dorëheqjen time. Në këto kushte, unë kam qenë i detyruar për të vazhduar gjykimin e çështjes. [...], duke paraqitur në cilësinë e provës, ndër të tjera dhe: (i) “Kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile”, të datës **.6.2016 dhe*

(ii) vendim nr. ***/**, datë **.6.2016, “Për shqyrtimin të kërkesës për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile”. Kujtojmë këtu që subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e zv./kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me shkresën nr. ***/** akti, datë **.10.2020, ka informuar Komisionin⁴ se nga verifikimi i kryer pranë indekseve alfabetikë civilë/penalë sistemi ICMIS nuk rezulton të jenë zhvilluar gjykime me shtetasin ***. ***, në cilësinë e paditësve, të paditur, të pandehur, nga subjekti i rivlerësimit Arben Dosti. Ndryshe nga sa ka konfirmuar me shkresën e mësipërme shqyrtimi gjyqësor provoi se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje në të cilat shtetasi *** ** ka qenë pjesëmarrës në proces, në të paktën dy raste (ku në të paktën në rastin e denoncuar nga “***” sh.a, ka pranuar padinë dhe ka shpërblyer paditësit që përfaqësoheshin nga av. *** ** në shumta të konsiderueshme). Marrë në konsideratë sa më sipër, duket sikur subjekti i rivlerësimit është përpjekur që gjatë procesit të rivlerësimit të mos ekspozojë të dhëna në lidhje me faktin se ai ka gjykuar çështje ku shtetasi *** ** ka qenë pjesëmarrës në gjykim.

4.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në analizë të akteve të administruara, si dhe referuar prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit. Aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit kanë të bëjnë me një tjetër çështje të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, ku si përfaqësues ligjor i njëjës prej palëve ndërgjyqëse ishte shtetasi *** ** dhe nuk kanë të bëjnë me çështjen gjyqësore konkrete pjesë e shkaqeve të ankimit. Subjekti i rivlerësimit në kushtet e një marrëdhënie pasurore dhe miqësore të provuar me shtetasin e mësipërm, kishte detyrimin të tregonte një vëmendje të shtuar në drejtim të trajtimit me koherencë të të gjitha situatave të tij të mundshme të konfliktit të interesit, edhe atij në dukje⁵. Në vlerësim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, edhe në rastin e gjykimit të çështjes me palë “***” sh.a., subjekti i rivlerësimit duhet që t’i drejtohej Kryetarit të Gjykatës me kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes (ashtu siç kishte vepruar edhe në rastin që subjekti i rivlerësimit paraqiti gjatë gjykimit në Kolegj).

4.3 Konflikti i interesit, sipas nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

4.4 Sa më sipër duket se subjekti gjendet në kushtet dhe situatën e konfliktit të interesit, në raport me kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005, pika 1, germa “b”, “dh” dhe nën-pika “v”, pasi nuk duhej të merrte pjesë në vendimmarrjen përkatëse, ku palë ndërgjyqëse ishte një shtetas, me të cilin ka pasur një marrëdhënie preferenciale, juridiko-civile apo angazhime të mëparshme miqësore.

⁴ Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë **.10.2021, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me kërkesën për informacion nëse subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar çështje gjyqësore të ndryshme civile/penale me palë ndërgjyqëse/kallëzues/të kallëzuar/të pandehur/të dëmtuar etj., ndër të tjerë, dhe me shtetasin ***. ***.

⁵ Referohuni vendimeve të Kolegjit, (JR) nr.15/2021, (JR) nr.10/2021, (JR) nr.16/2020.

5. Çështja penale me të pandehur shtetasin *** ***, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 të Kodit Penal

5.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se, edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit konkret mbeten të njëjta.

5.2 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka dërguar për gjykim dhe ka kërkuar deklarimin fajtor të shtetasit ***. ***, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 të K. Penal, dhe dënimin me tre vjet e gjashtë muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të K. Pr. Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke u dënuar përfundimisht me 2 vjet e 4 muaj burgim. Mbrojtësi ligjor i të pandehurit ka kërkuar të aplikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit, parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal.

5.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. **-2017-***/***, datë **.3.2017, e përbërë nga subjekti i rivlerësimit si gjyqtar i vetëm, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit ***. ***, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 të K. Penal, dhe dënimin me 3 (tre) vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të K. Pr. Penale dënimit i zbritet 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin me 2 (dy) vjet burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke e vendosur në provë të pandehurin ***. ***, për një periudhë prej 2 vjetësh, me kusht që gjatë kësaj periudhe prove të mos kryejë veprë tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, Gjirokastrë.

5.4 Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është ankimuar nga organi i Prokurorisë, lidhur me zbatimin e nenit 59, të Kodit Penal. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. **-2017-***/***, datë **.9.2017, ndër të tjera, ka vendosur: [...] ndryshimin e vendimit sa i përket mënyrës së vuajtjes së dënimit, duke u vendosur mosaplikimi i nenit 59 të Kodit Penal [...].

5.5 Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka çmuar se në rastin në shqyrtim nuk duhet të aplikohet neni 59, i Kodit Penal, duke argumentuar se: [...] *kriteri bazë i aplikimit të këtij neni është rrezikshmëria e paktë e personit dhe plotësimi i disa kushteve të tjera, siç është mosha, kushtet shëndetësore etj. Nga studimi i rrethanave të ngjarjes rezulton se sasia e bimëve narkotike të mbjella nga i pandehuri është relativisht e lartë (rreth 466 rrënjë), gjë që flet për rrezikshmëri jo të paktë të të pandehurit ***. ***. Fakti që prindërit janë pensionistë, nuk justifikon aplikimin e nenit 59 të K. P. Gjithashtu, nuk provohet që i pandehuri është i punësuar e, për rrjedhojë, që me këto të ardhura mban familjen. Sa më sipër, Gjykata e Apelit, bazuar dhe në faktin që kjo veprë penale është shumë e përhapur e është bërë fenomen shqetësues si kombëtar, edhe ndërkombëtar, çmon se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë duhet të ndryshohet vetëm sa i përket aplikimit të nenit 59 të K. Penal [...].*

5.6 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, pa kaluar në përsëritje, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 4.2.2022, konstaton se aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, me argumentimin se: *bima narkotike është në fazë inkubatori apo arsyetimi se veprat*

penale në fshehtësi nuk dihen dhe nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në rendin dhe sigurinë publike, duke mos referuar bazën përkatëse ligjore ose ndonjë jurisprudencë unifikuese, tregojnë për mangësi në kuptimin e interpretimit të ligjit penal material, si dhe në cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, për më tepër në kushtet kur bëhet fjalë për veprën penale të “Kultivimit të lëndëve narkotike”, gjerësisht e përhapur dhe, për këtë arsye, e një rrezikshmërie të posaçme shoqërore dhe, si të tilla, duhen vlerësuar nga indikatorët e përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit.

5.7 Mangësitë e mësipërme duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose të trajtohen në vlerësim tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

6. Lidhur mbi shkakun ankimor mbi trajtimin e informacioneve nga burimet e hapura, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se, edhe pas shqyrtimit gjyqësor të këtij rasti në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit konkret mbeten të njëjta.

6.1 Komisioni ka trajtuar në vendimin objekt ankimi edhe një informacion të përfutur nga burime të hapura, ku duket se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka vendosur masën e sigurimit personal “arrest shtëpie” për shtetasit ***. ***.⁶ dhe ***. ***, për të cilët raportohet se janë arrestuar në flagrancë me 58 kg lëndë narkotike të llojit *cannabis sativa*.

6.2 Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁷, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka dërguar⁸ fashikullin e procedimit penal me nr. ***, i vitit 2017, regjistruar për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, që lidhet me ngjarjen e referuar si më sipër, të raportuar në media. Subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtari që ka shqyrtuar vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit për shtetasin ***. ***.

6.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e përbërë nga subjekti i rivlerësimit gjyqtar i vetëm, me vendimin nr. ***/**-2017-***, datë **.6.2017, ka vendosur: (i) vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe (ii) caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi” me mbikëqyrje elektronike, parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale dhe ligji nr. 10496/2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

6.4 Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. **-2017-***/**, datë **.7.2017, ka vendosur: (i) miratimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, sa i përket disponimit për vleftësimin “arrest në flagrancë” ndaj personit nën hetim ***. ***,; (ii) ndryshimin e këtij vendimi sa i përket disponimit për caktimin

⁶ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.5.2021, informon se për shtetasin ***. ***, prokurori i çështjes ka vendosur pushimin e çështjes me vendimin e datës **.10.2017.

⁷ Referohuni shkresës nr. *** prot., datë **.10.2021.

⁸ Referohuni shkresës nr. ***/* prot., datë **.10.2021.

e masës së sigurimit, duke i dhënë masën e “arrestit me burg”, sipas nenit 238 të K. Pr. Penale.

6.5 Gjykata e Apelit ka vlerësuar ndryshe lidhur me elementet e: (i) rrezikut të ikjes; (ii) mundësisë që personi nën hetim të ndërhyjë në procesin e drejtësisë; dhe (iii) përshtatshmërisë së masës së sigurimit në raport me sanksionin penal të parashikuar për veprën penale për të cilën ky person dyshohet të ketë kryer.

6.6 Pa kaluar në përsëritje, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 4.2.2022, konstatojmë se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ i këtij rasti, duhen vlerësuar nga indikatorët e përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit. Mangësitë e mësipërme duhen konsideruar në vlerësim tërësor të çështjes, për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose të trajtohen në vlerësim tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

7. Lidhur mbi shkakun ankimor mbi gjetjet e evidentuara nga Raporti i vlerësimit profesional të hartuar nga KLGJ-ja, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se, edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit konkret mbeten të njëjta.

7.1 Nga Raporti i vlerësimit profesional të hartuar nga KLGJ-ja, ndër të tjera, për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar si më poshtë:

7.1.1 Aftësitë profesionale: (i) Në një rast është konstatuar se gjyqtari nuk ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e procesit në mungesë të palës së paditur (shih dosjen 5); (ii) Në dy raste është vërejtur se në vendimin përfundimtar gjyqtari nuk ka përcaktuar palën të cilit i ngarkohen shpenzimet referuar nenit 106 të K. Pr. Civile (shih dokumentin 2 dhe dosjen 1); (iii) Ndërsa, në dy raste të tjera, konstatohet se gjyqtari nuk ka disponuar për heqjen e masës së sigurimit të caktuar ndaj të pandehurit, në kundërshtim me detyrimin e parashikuar në nenin 389 të K. Pr. Penale (shih dokumentin 1 dhe dosjen 4).

7.1.2 Arsyetimi ligjor: (i) Në rastet e zgjidhjes së martesës, gjyqtari përdor në mënyrë të standardizuar paragrafë me referencë të kuadri ligjor i aplikueshëm, por konstatohet se në këto vendime pjesa arsyetuese paraqitet përgjithësisht teorike, nuk analizohet asnjë provë apo pohim gjyqësor mbi bazën e të cilave gjyqtari të ketë arritur në konkluzionin se padia duhet pranuar (shih dokumentin 2 dhe dosjen 1); (ii) Gjithashtu, në një prej këtyre vendimeve mungon analiza konkrete rreth nevojave të fëmijëve dhe mundësisë së prindërve për caktimin e masës së pensionit ushqimor në favor të fëmijëve të mitur (shih dokumentin 2). Në 1 rast gjykimi të një çështje civile me objekt përmbushje detyrimi nuk përdoret një metodologji e caktuar në arsyetimin e vendimit dhe konstatohet se arsyetimi është i qartë, i kuptueshëm, por pa ndonjë analizë të thelluar (shih dosjen 5); (iii) Përgjithësisht, në 3 dokumentet dhe 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se gjyqtari nuk citon provat, mbi të cilat palët kanë provuar faktet e pretenduara prej tyre; (iv) Në dy raste është vërejtur se në vendimin përfundimtar gjyqtari nuk ka përcaktuar palën të cilit i ngarkohen shpenzimet, referuar nenit 106 të

K. Pr. Civile (shih dokumentin 2 dhe dosjen 1). Ndërsa, në dy raste të tjera, konstatohet se gjyqtari nuk ka disponuar për heqjen e masës së sigurimit të caktuar ndaj të pandehurit (shih dokumentin 1 dhe dosjen 4).

7.1.3 Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore: (i) *Tek 1 çështje penale e vëzhguar, planifikimi i seancës së parë gjyqësore është planifikuar për një afat 9 ditë, duke mos u respektuar afati 10-ditor i njoftimit të të pandehurit para datës së zhvillimit të seancës të parashikuar nga neni 333/2 të K. Pr. Penale (shih dosjen 3).*

7.2 Komisioni, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit për gjetjet e listuara në këtë raport, ka çmuar se: [...] *nuk konstatohen problematika thelbësore lidhur me vlerësimin e kriterit profesional [...] (f. 43 e vendimit).*

7.3 Nisur nga rrethanat konkrete vlerësojmë se, edhe në këtë rast, të dhënat që përmban raporti i vlerësimit profesional të hartuar nga KLGJ-ja, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose të trajtohen në vlerësimin tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

8. Në përfundim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në analizë të provave dhe akteve të administruara, vlerëson se përfundimi i Komisionit në rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale është i cenueshëm. Referuar nenit 4, pika 2, nenit 61, pika 4 dhe/ose 5 e ligjit nr. 84/2016, duket se mangësitë e vërejtura janë të tilla, që nuk justifikojnë ose të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë.

IV. Kërkimi përfundimtar

9. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 4.2.2022, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, pikës 2, të nenit 4, pikës 2, 3, 4 dhe/ose 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti.

DREJTUESI I PROKURORISË SË POSAÇME

Altin DUMANI